

LINDITA ÇIFÇI

ZBATIMI I KOMPETENCËS SË TË DËGJUARIT NË TEKSTIN E NXËNËSIT “GJUHA SHQIPE 6”

Të dëgjuarit si proces në kurrikulën me kompetenca

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe 2010 është dhënë përkufizimi:
¹*dëgjoj- kap ose kam aftësinë a mundësinë të kap me anë të veshit tingujt, zërat, zhurmat, dhe Dëgjim- veprimi sipas foljes- aftësia e njeriut a kafshës për të dëgjuar.*

Dëgjimi si proces fiziologjik ndryshon nga të dëgjuarit aktiv që synon të kultivojë kurrikula e gjuhës shqipe. Të jesh një dëgjues i mirë nuk mjafton thjesht të dëgjosh me ndihmën e shqisës së të dëgjuarit, e rëndësishme është të vësh në punë të menduarit, me qëllim që të marrësh informacionin e duhur, pra të dëgjosh në mënyrë aktive.

Të dëgjuarit aktiv është një proces më i ndërlikuar, pasi në të cilën përfshihet jo vetëm perceptimi si dukuri fiziologjike, por edhe marrja e informacionit, interpretimi i tij dhe reagimi ndaj mesazheve të marra.

“Nëse do të duhej të flisnim më shumë se të dëgjonim, atëherë ne do të kishim dy gjuhë dhe një vesh.” shkruan Mark Twain.

Njeriu gjatë një dite dëgjon shumë tinguj, zhurma, biseda, por jo ndaj të gjithave atyre që percepton reflekton në mënyrë aktive. Shumë syresh vijnë instinktivisht dhe po ashtu kalojnë pa ndonjë reagim të veçantë, ndërsa për disa të tjera atij i duhet t’i kuptojë e më pas të reagojë ndaj tyre.

Të dëgjuarit aktiv nënkupton të dëgjuar me të gjitha shqisat, leximin e gjuhës së trupit të folësit, duke ndjekur çdo lëvizje, sjellje, ndryshime të mimikës, gjesteve e gjithçka që ‘flet’. Por kjo nuk lind instinktivisht, pasi është një aftësi që mund të fitohet dhe zhvillohet në proces.

Nëse doni të kuptoni një person, mos i dëgjoni vetëm fjalët, por vëzhgoni sjelljet e tij” ka thënë Albert Ajnshtajni.

¹ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 2010.

Për të qenë dëgjues të mirë dhe për të reaguar në mënyrë të saktë dhe të drejtë ndaj mesazheve, kjo nuk mund të realizohet në mënyrë të njehershme dhe brenda një ore mësimi, pasi është një proces i ndërgjegjshëm, i cili skalitet duke u praktikuar në mënyrë graduale e të qëllimshme dhe kërkon kohë dhe durim për t'u realizuar.

Të dëgjuarit është çelësi për të pasur një komunikim efektiv dhe për të qenë të suksesshëm.

Të rriturit shpenzojnë një mesatare prej rreth 70% të kohës së tyre të angazhuar në lloje të ndryshme komunikimi, nga ku rreth 45% shpenzohen duke dëgjuar, 30% duke folur, 16% për të lexuar dhe rreth 9% për të shkruar. (Adler, R. et al. 2001)².

Kompetenca e të dëgjuarit dhe teksti i nxënësit

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka të dëgjuarit në transmetimin e informacioneve dhe në komunikim, në kurrikulën e gjuhës shqipe i kushtohet një rëndësi e veçantë përfitimit të kompetencës së të dëgjuarit.

Për të realizuar fizionominë e kurrikulës me kompetenca një ndikim të madh ka hartimi i tekstit të nxënësit, pasi nëpërmjet tij duhet të përçohet tek mësuesit dhe nxënësit një qasje e re të nxëni me situata që i mundëson nxënësit të mësojnë nëpërmjet socializimit, vizualizimit, dëgjimit, arsyetimit, reflektimit dhe imitimit.

Një vend të posaçëm në këtë krye i kemi kushtuar studimit të teksteve aktuale për të cilat pretendohet se janë hartuar në bazë të qasjes së kurrikulës me kompetenca duke analizuar shkallën e përmbushjes së njohurive, shkathësisive, qëndrimeve dhe vlerave të parashtruara në programin lëndor.

Në librin “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore” theksohen funksionet e shumta që realizon një tekst shkollor si: *funksione që lidhen me procesin mësimor dhe funksione që lidhen me jetën e përditshme profesionale, funksione këto që transmetojnë njohuri, zhvillojnë aftësi, përforcojnë dhe vlerësojnë dijet.*³

Ne i jemi referuar konkretisht tekstit të ***gjuhës shqipe 6*** për të evidentuar:

Shkallën e përmbushjes së kërkesave sipas qasjes së kompetencave në përshtatje me programin;

Shkallën e përmbushjes së kompetencave kyçe dhe ato të lëndës;

² <https://elcomms.com.au/effective-communication/listening-forgotten-communications-skill/>

³ Instituti i Studimeve Pedagogjike, Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore, Tiranë 2003.

Zbatimi i kompetencës së të dëgjuarit në tekstin e nxënësit...

Zbatimin e rezultateve të të nxënësit;

Sa ka ndihmuar tekstin në paraqitjen dhe përcaktimin e situatave të të nxënësit në njësi mësimore të ndryshme;

Nëse janë hartuar pyetje dhe ushtrime që t'i përmbahen udhëzimeve të kësaj kurrikule etj.

Në programin lëndor “Gjuha shqipe 6” është planifikuar koha mësimore sipas pesë kompetencave, ku për **kompetencën të dëgjuarit** e teksteve të ndryshme është sugjeruar të zhvillohen 10 orë mësimi. Kompetenca e të dëgjuarit nuk mund të konceptohet të përfitohet e veçuar nga kompetencat e tjera, të folurit, të lexuarit e të shkruarit, pasi në çdo orë mësimi nxënësi dëgjon, lexon, flet dhe shkruan. etj.

Njohuritë sipas kompetencës së të dëgjuarit dhe raporti i tyre me programin dhe tekstin e nxënësit;

Duke pasur parasysh se kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, ne do t'i shqyrtojmë të gjithë këta elementë përbërës në mënyrë të veçantë sipas kompetencës së të dëgjuarit.

Nga **teksti “Gjuha shqipe 6”**, po vëzhgojmë se në ç'raport janë planifikuar njohuritë e tekstit të nxënësit me programin lëndor.

Marrja e njohurive ka një ndikim pozitiv te nxënësi për t'u kthyer më pas në kompetencë. Për këtë teksti duhet të përmbajë informacione që të jenë në përputhje me programin lëndor dhe të trajtohen në përshtatje me moshën, formimin dhe zhvillimin intelektual të nxënësit.

Referuar studimeve të hollësishme të tekstit të nxënësit, shohim se në të përgjithësisht janë hartuar të gjitha llojet e teksteve mbi të cilat do të punojë nxënësi për të treguar përmbajtjen ose brendinë, duke analizuar dhe dhënë gjykime të thjeshta në përshtatje me moshën sipas programit lëndor, por lidhur me planifikimin e njohurive janë lënë jashtë trajtimit:

Renditja e ngjarjeve në një tekst;

Identifikimi i shkakut dhe pasojës në një tekst;

Identifikimi i problemit dhe i zgjidhjes në një tekst,

Njohuritë e përshkruara më sipër janë lënë jashtë prezantimit me material informues. Mungesa e njohurive të përcaktuara në programin lëndor penalizon nxënësin për të përfutur njohuritë e sipërpërmendura. Këto kërkesa të programit janë trajtuar në formë ushtrimesh duke kaluar drejtpërdrejt në përfitimin e shkathtësive, vlerave e qëndrimeve, por pa marrë më parë njohuritë e nevojshme për to.

Shkathësitë sipas kompetencës së të dëgjuarit dhe raporti i tyre me programin dhe tekstin e nxënësit;

Duke pasur parasysh se rezultatet e të nxënit pasqyrohen nëpërmjet shkathësitëve, ne po i referohemi këtyre të fundit.

Në program⁴ parashtrihen *rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit* sipas të cilave:

- nxënësit kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose prezantuara si dhe reflekton për to;

- jep mendime dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Nga studimi i *tekstit “Gjuha shqipe 6”*, po kundrojmë se në ç’skallë janë realizuar rezultatet e kompetencës së të dëgjuarit në këtë tekst;

- A janë të mjaftueshme ushtrimet e hartuara në tekst për të përvetësuar plotësisht rezultatet e të nxënit.

- Sa mundësojnë ushtrimet për zhvillimin gradual të kompetencave; a janë në nivele të ndryshme dhe a janë trajtuar në thellësi, në gjerësi dhe nga këndvështrime të ndryshme?

- A mund të themi plotësisht se nxënësi ka mundur përfitimin e rezultateve të të nxënit me këto shkallë ushtrimesh?

Të dëgjuarit aktiv dhe i qëllimshëm është një shkathësi që mund të fitohet dhe zhvillohet me praktikë. Për këtë qëllim në tekst është punuar nëpërmjet ushtrimeve për zhvillimin e kompetencës së të dëgjuarit sipas rezultateve të të nxënit:

Duke iu referuar hulumtimeve për realizimin e shkathësitëve të kompetencës së të dëgjuarit në përputhje me programin lëndor, arrijmë në këto përfundime:

- Në tre prej rezultateve të të nxënit ose afërsisht **20%** e rezultateve sipas kompetencës së të dëgjuarit nuk është ushtruar asnjë veprimtari a ushtrim për përfitimin e shkathësitëve dhe qëndrimeve. Mungesat janë kryesisht për këto shkathësi:

Bën parashikime rreth tekstit që do të dëgjojë;

Pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë;

Identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetër).

- Në katër prej rezultateve të të nxënit ose **26%** të rezultateve sipas kompetencës së të dëgjuarit është hartuar vetëm një ushtrim.

⁴ Programi i lëndës “Gjuhë shqipe” shkalla e tretë dhe e katërt.

Zbatimi i kompetencës së të dëgjuarit në tekstin e nxënësit...

Dallon rendin e ngjarjeve dhe ideve;

Dallon ndjenjat e folësit.

Dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst;

Përcakton me ndihmën e mësuesit qëllimin ose synimin e folësit (këshillon, bind, sqaron etj.);

- Në katër prej rezultateve të të nxënësve ose **26%** të rezultateve sipas kompetencës së të dëgjuarit janë hartuar nga dy ushtrime.

Kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose rreth përmbajtjes së tekstit.

Kërkon informacion shtesë;

Tregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen ose brendinë e tekstit;

Dallon shkakun dhe pasojën në një tekst;

- Në një prej shkathtësive ose **7%** të rezultateve sipas kompetencës së të dëgjuarit janë hartuar nga tre ushtrime:

Mban shënime gjatë të dëgjuarit;

- Në tre prej shkathtësive ose **20%** të rezultateve sipas kompetencës së të dëgjuarit janë hartuar nga katër ushtrime:

Përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për kënaqësi, për informacion, për kuriozitet).

Interpreton tekstin duke dhënë gjykimet e tij;

Klasifikon detajet në një tekst;

Në këtë kumtesë po paraqes vetëm ato rezultate të nxënësve që nuk janë trajtuar me asnjë ushtrim në tekstin e nxënësve duke e penalizuar nxënësin për të mos përfituar shkathtësi, vlera e qëndrime, gjë që ndikon negativisht në formimin e nxënësve dhe në një farë mënyre edhe mangësi në lëndët e tjera, pasi gjuha është jo vetëm lëndë, por ndërlëndë dhe luan një rol mjaft të rëndësishëm për ecurinë e të gjitha kurrikulave shkollore.

Bën parashikime rreth tekstit që do të dëgjojë;

Një nga tiparet kryesore të të menduarit është parashikimi. Teknika e parashikimit është një element i rëndësishëm që ndikon jo vetëm në të kuptuarit e pjesës, por edhe në zhvillimin e të menduarit kritik, në zhvillimin e fantazisë dhe të botës emotive, në mundësinë e ngritjes së hipotezave si dhe ndihmon për të ngritur njohuritë e nxënësve në një nivel më të vetëdijshëm.

Përmes një pjese të dëgjuar, nxënësve u kërkohet të imagjinojnë atë çka do të ndodh më pas.

Parashikimi rreth një teksti të caktuar, rrit interesin e nxënësve dhe e nxit atë të dëgjojë me vëmendje nëse parashikimi i tij ka përputhshmëri me fragmentin që do të dëgjojë.

Por ky rezultat të nxëni nuk u evidentua të trajtohet në asnjë nga orët sipas kësaj kompetence.

Mosplanifikimi i këtij rezultati të nxëni në tekstin gjuha shqipe 6 “penalizon” nxënësin për përfitimin e njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve sipas këtij rezultati.

Për këtë shkathtësi *sugjerohet* të hartoheshin në tekst kërkesa detyrash të tilla si:

Dëgjoni titullin e pjesës dhe parashikoni se për çfarë flitet në të;

Lexoni titullin e pjesës, vështroni figurën, për çfarë mendoni se rrëfen autori?

Para se të dëgjoni pjesën vëreni fotografitë, mendohuni e kujtoni me cilën ngjarje lidhen.

Vëreni figurat dhe mendoni për ngjarjen. Tregoni një variant se çfarë mund të ketë ndodhur sipas mendimit tuaj;

Mendoni një mbyllje për...fabulën dhe ballafaqojeni me zgjidhjen që i jep teksti.

Pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë;

Këto lloj ushtrimesh ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkallën e të kuptuarit të një teksti të dëgjuar, të lexuar apo të folur si dhe në shkallën e përvetësimit të informacionit të dhënë.

Nëse në një fragment të dëgjuar a të lexuar nxënësit kanë paqartësi të llojeve të ndryshme, fjalë a nocione të pakonceptueshme prej tyre, informacioni nuk perceptohet i plotë e në thellësi, gjë që ndikon në të kuptuarit e më pas në procese të niveleve më të larta.

Ky rezultat të nxëni nuk u evidentua të zbatohet në asnjë nga orët e hartuara sipas kësaj kompetence, pasi nuk rezultojnë ushtrime të tilla për të cilat nxënësi duhet të kërkojë informacion në lidhje me ide, koncepte, a fjalë të cilat janë të panjohura për të apo që i ka dëgjuar, por nuk njeh kuptimin e tyre.

Mosrealizimi i këtij rezultati ndikon negativisht në formimin e nxënësit dhe në mënyrë të tërthortë edhe në përvetësimin e programeve të fushave të tjera kurrikulare.

Kështu në lidhje me këtë rezultat të nxëni mund të hartoheshin ushtrime të tipit:

- *Pyet nënën, gjyshin, gjyshen për....*

- *Pyet mësuesin për....*

- *Pyet shokun për...*

- *Kërko informacion në libra, revista, internet...*

Zbatimi i kompetencës së të dëgjuarit në tekstin e nxënësit...

- Zbulo nëpërmjet fjalorëve të gjuhës shqipe, apo dhe fjalorëve të tjerë kuptimin kontekstual të fjalës....

Identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetër).

Qëllimi është që të bëhet krahasimi i informacionit të vjelë nga burime të ndryshme duke evidentuar elementët e përbashkët dhe ndryshimet midis këtyre burimeve të informacionit.

Pra nevojitet që të interpretohet i njëjti informacion përcjellë në rrugë apo burime të ndryshme; kështu mund të bëhet krahasimi midis informacionit të vjelë nga interneti, nga revista, gazetata, televizioni, nga prindërit...etj. si dhe të dalë në pah ngjashmëria dhe dallimi midis burimeve të ndryshme të informacioneve të vjela nga nxënësit.

Në tekstin që ne po shqyrtojmë nuk është formuluar dhe nuk është praktikuar asnjë ushtrim që të përmbushë me përpikmëri kërkesat e parashikuara në program për zhvillimin e shkathtësive dhe qëndrimeve sipas këtij rezultati të nxëni.

Për këtë shkathtësi **sugjerohet** të hartoheshin në tekst kërkesa detyrash të tilla si:

Për një ngjarje të ndodhur kohët e fundit bëni dallimin midis informacioneve të marra nga opinionet e njerëzve dhe mënyrën se si e paraqesin mediat e gazetave të ndryshme.

Konkluzione rreth problematikave të kompetencës së të dëgjuarit

Duke iu referuar informacioneve të mësipërme për kompetencën e të dëgjuarit konstatojmë se jo të gjitha njohuritë e përcaktuara në program janë planifikuar për t'u realizuar në tekst.

Shkalla e aplikimit të rezultateve të të nxënit me anë ushtrimesh nuk është kryer në mënyrë të njëjtë. Disa rezultate janë praktikuar në disa drejtime të ndryshme me anë të ushtrimeve në njësi të ndryshme mësimore, ndërsa disa të tjera janë punuar pak ose aspak.

Kështu vetëm 27% e rezultateve të të nxënit sipas kompetencës së të dëgjuarit janë trajtuar në mënyrë të plotë nëpërmjet ushtrimeve të hartuara në tekst.

Ushtrimet mundësojnë zhvillimin gradual të kompetencave, i përkasin nivele të ndryshme dhe janë trajtuar në thellësi, në gjerësi dhe nga këndvështrime të ndryshme. Ato synojnë jo vetëm riprodhimin e pjesës me anë të dialogut pyetje-përgjigje dhe të kuptuarin e fragmentit, por edhe

tentojnë formimin e nxënësit sipas shkallëve më të larta të arritjes të gjykimit dhe argumentimit të dukurive.

Kështu pikësynimi i ushtrimeve të hartuara në tekstin e nxënësit përqendrohet te nxjerrja e detajeve, përcaktimi i fjalëve kyç, te formulimi i mesazhit, te zbulimi i fakteve si edhe te argumentimi veprimeve shkak-pasojë, të cilat i përkasin nivele të ndryshme të kësaj taksonomie.

53% e rezultateve të të nxënësit sipas kompetencës së të dëgjuarit janë trajtuar në mënyrë të pjesshme, nëpërmjet 1 a 2 ushtrimeve të hartuara në tekst. Realizimi i një rezultati të nxënësit me një numër të kufizuar ushtrimesh sjell si pasojë që njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet të zhvillohen në mënyrë të pjesshme dhe formimi i nxënësit të jetë fragmentar dhe jo i plotë.

20% e rezultateve të të nxënësit sipas kompetencës së të dëgjuarit nuk është punuar në tekst me asnjë ushtrim. Kjo gjë ndikon negativisht te nxënësi, si pasojë nuk zhvillon njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet sipas këtyre rezultateve të nxënësit.

Situatat e të nxënësit janë perceptuar në mënyrë të përciptë, gjë që shpreh qartë se nuk është tepër e qartë kjo risi e qasjes së kompetencave. Temat mësimore vijojnë të konstruktohen në mënyrën tradicionale sipas qasjes me objektiva mësimore.

Nuk i është kushtuar rëndësi të dëgjuarit si proces, pasi në pak raste praktikohet teknika e të dëgjuarit të vëmendshëm e të qëllimshëm. Janë hartuar pak ose aspak kërkesa për të dëgjuar në mënyrë dhe mjete auditive që mund të përdoren si modele dhe materiale ilustruese, si: incizime në magnetofon nga interpretues të fjalës artistike, aktorë të gjinive të ndryshme, të lexuara nga mësuesit, apo dhe regjistrime të tregimeve të nxënësve etj., radio etj.

Trajtimi i temave dhe orëve mësimore janë konstruktuar në mënyrën tradicionale e sipas traditës së mësimnxënies me objektiva dhe nuk janë përshkruar situata të ndryshme të të nxënësit ku të përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale.

Pak është punuar për të ndërthurur procesin e të dëgjuarit me ilustrimet figurative dhe me anën grafike, e rëndësishme kjo në evidentimin e proceseve shkak-pasojë apo në rrjedhën e ngjarjeve etj.

Kompetencat vijojnë të trajtohen të shkëputura nga njëra-tjetra dhe nuk ndiqet një vijueshmëri logjike ku të prezantohet një situatë e caktuar mbi të cilën nxënësit të operojnë sipas të pesë kompetencave gjuhësore.

Zbatimi i kompetencës së të dëgjuarit në tekstin e nxënësit...

Sugjerime për disa ndryshime

Teksti duhet t'i kushtojë më tepër rëndësi të dëgjuarit si proces duke praktikuar më tepër teknika të të dëgjuarit të vëmendshëm e të qëllimshëm duke hartuar kërkesa për të dëgjuar me mjete auditive, incizime në magnetofon nga interpretues të fjalës artistike, aktorë të gjinive të ndryshme, pjesë të lexuara nga mësuesit, apo dhe regjistrime të tregimeve të nxënësve etj., radio etj.

Teksti i nxënësit të hartojë në krye të temave mësimore situata të nxëni të ngjashme me zbatimet në botën reale, mbi bazën e të cilave të hartohen pyetje për të zhvilluar të pesë kompetencat e fushës;

Të trajtohen të gjitha njohuritë e përcaktuara në programin lëndor;

Të hartohen ushtrimet për përfitimin e shkathtësive, vlerave e qëndrimeve sipas të gjitha rezultateve të të nxënit në përputhje me programin lëndor;

Të alternohet më tepër procesi i të dëgjuarit me anën vizuale, ilustrimet figurative dhe me anën grafike.

